



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHEM

Nr. dokumentit: 23.10c.8-2012-08

**RAPORT I AUDITIMIT PËR MBIQYRJEN E SISTEMIT TË
MBETURINAVE DHE OFRIMIT TË SHËRBIMEVE NGA KRM
EKOREGJIONI-PRIZREN PËR VITIN 2012**

Prishtinë, Shtator 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për konkluzionin e auditimit mbi vlerësimin e sistemit aktual monitorues të menaxhimit të mbeturinave në Regjionin e Prizrenit, në konsultim me Zv. Auditorin e Përgjithshëm, Artan Venhari i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Konkluzioni dhe raporti i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Myrvete Gashi mbështetur nga Jusuf Kryeziu (Udhëheqës i ekipit), Ganimete Dalloshi dhe Ylber Sadiku.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	9
2 Funksionimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave.....	11
2.1 Funksionimi i KRM-së	14
3 Të gjeturat e KRM-së	16
4 Menaxhimi i mbeturinave nga niveli komunal	20
5 Mbikëqyrja e kompanisë së mbeturinave	21
Shtojca I: Metodologjia e auditimit	25
Shtojca II: Kërkesat ligjore/ administrative të cilat ndikojnë në menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Prizrenit dhe Komunitat tjera përkatëse të këtij regjioni	26
Shtojca III: Pasqyra e standardeve dhe kritereve për dhënien e shërbimeve dhe vlerësimin e ofrimit të shërbimeve nga KRM Ekoregjioni.....	29

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
BD	Bordi i Drejtorëve
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KK	Kuvendi Komunal
KKA	Komisioni Komunal i Aksionareve
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
KP	Komuna e Prizrenit
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZRRUM	Zyra e Rregullatorit për Uji dhe Mbeturina

Përmbledhje e përgjithshme

Qëllimi parësor i këtij auditimi ishte vlerësimi i sistemit aktual monitorues të menaxhimit të mbeturinave në Prizren. Për më tepër, sugjeron fusha për përmirësim në nivel lokal në kuadër të monitorimit dhe standardeve për ofrim të shërbimeve.

Korniza e kriterëve përfshinë vlerësimin e sistemeve të monitorimit, procesit të monitorimit dhe vlerësimin e shërbimeve. Kriteret bazohen në legjislacion, udhëzime administrative dhe standarde që rregullojnë administrimin dhe organizimin e menaxhimit të mbeturinave. Kriteret dhe përmbushja e tyre janë prezantuar në tërësi në shtojcat II dhe III .

Metodologjia e këtij auditimi ka përfshirë intervista në nivelin lokal si dhe në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave (KRM) Ekoregjioni.. Ai ka rishikuar procesin më të gjërë të përkufizimit të qëllimeve nga komuna, ka monitoruar rolin mbikqyrës të Komisionit Komunal të Aksionarëve (KKA), ka rishikuar sistemet e kontrollit, implementimin e tyre dhe menaxhimin e aktiviteteve operative dhe ka analizuar planet dhe raportet operative. Auditimi është mbështetur në teste, intervista, rishikime analitike, rishikime të dokumenteve dhe verifikim fizik për të vlerësuar vlefshmërinë e shërbimeve. Metodologjia e përdorur në këtë auditim është e prezantuar në tërësi në shtojcën I.

Auditimi konkludoi se pengesat në procesin e mbledhjes së të hyrave dhe mbledhjes së mbeturinave ndikojnë cilësinë dhe metodën e ofrimit të shërbimeve. KRM-ja ballafaqohet me mungesë të parakushteve për të operuar si duhet, bashkarisht me mos vullnetin e konsumatorëve për t'i kontraktuar shërbimet e tyre, gjë e cila është shkaktari kryesor i dështimit për tu zgjeruar.

Komuna është ballafaquar me pasiguri rreth obligimeve dhe përgjegjësi për shkak të rregullave të pamjaftueshme komunale dhe nuk ka mundur të ofrojë një sistem të qartë për monitorim dhe menaxhim. Organet mbikëqyrëse nuk kanë operuar si duhet dhe kanë dështuar t'i ofrojnë informata Asamblesë Komunale, dhe prandaj çështjet kanë mbetur të paadresuara. Sistemet e raportimit brenda të gjithë institucioneve të përfshirë janë joadekuatë. Si pasojë, ka mungesë të llogaridhënies në këtë sektor.

Ky auditim u ofron rekomandime komunës lidhur me atë se si t'i përmirësojë parakushtet e operimit, t'i zhvillojë sistemet e organizimit dhe qartësisht të përgjegjësi, dhe raportimin sipas kërkesave të mirë përkufizuara për të siguruar llogaridhënie. Në fund KRM-ja është rekomanduar të kryej aktivitete më të mira të planifikimit, monitorimin e ofrimit të shërbimeve, raportimin, i cili duhet të jetë i strukturuar dhe cilësor, dhe; zhvillimin e kontroleve operative të brendshëm. Rekomandimet në tërësinë e tyre mund të gjenden në faqen 27-28.

Autoritetet përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e mbeturinave janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Komuna e Prizrenit si dhe Komunitet tjerë përkatës të Regjionit të Prizrenit. Përgjegjësia për grumbullimin e mbeturinave është e Kompanisë Regjionale të Mbeturinave (KRM) Ekoregjioni.

Zona e operimit të KRM Ekoregjioni është Komuna e Prizrenit dhe komunitet tjerë përkatës të këtij regjioni janë duke u sfiduar me një numër të problemeve në menaxhimin e mbeturinave, veçanërisht mos shtrirja e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave për të gjithë popullsinë e regjionit të Prizrenit. KRM Ekoregjioni në përgjithësi ka kryer shërbimet në bazë të licencës dhe obligimeve që ka, ndërsa niveli i shërbimeve duhet të përmirësohet.

Ky auditim është i fokusuar në sistemin e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e mbeturinave, shqyrton kornizën ligjore brenda të cilës ofrohen këto shërbime. Përbrenda kësaj kornize ne kemi shqyrtuar rolet dhe përgjegjësitë e secilit nga institucionet dhe kontrollet/mbikëqyrja e zbatuara nga secili.

Në vijim do të pasqyrojmë të gjeturat të përgjithësuara për Regjionin e Prizrenit dhe KRM Ekoregjionin:

Niveli lokal

- Komuna e Prizrenit ende nuk ka organizuar procesin e klasifikimit të mbeturinave;
- Komuna e Prizrenit – KP nuk e ka organizuar si duhet sistemin për menaxhimin e mbeturinave dhe nuk ka nxjerr akte të mjaftueshme nënligjore;
- Nuk ka përgatitur planin lokal për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe nuk është raportuar në Ministri;
- Largimi i mbeturinave nga sipërfaqet publike nuk është në nivel dhe Inspektorati komunal nuk ka arritur të zbatoj si duhet autorizimet e tyre; dhe
- Komuna nuk ka formuar Komision komunal Të Aksionarit – KKA. Andaj në mungesë të këtij komisioni, komuna nuk ka arritur të realizojë:
- Miratimin dhe nxjerrjen e Politikës së pronësisë ;
- Mbikëqyrjen nga Aksionarët; dhe
- Raportimin para publikut mbi performancën e aksionarëve,

Kompania e pastrimit

- Ende nuk i ka shtrirë shërbimet e mbledhjes së mbeturinave në gjithë territorin lokal;
- Nuk ka arritur të bëjë regjistrimin e të gjithë konsumatorëve që shfrytëzojnë shërbimet e kompanisë dhe një numër i lartë i konsumatorëve janë pa kontrata;
- Organizimi dhe kontrollet në kompani lidhur me shërbimt e mbeturinave nuk janë mjaft të mira dhe mungon raportimi adekuat për nivelin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Konkluzion

Sistemi lidhur me administrimin dhe menaxhimin e mbeturinave në përgjithësi nuk është dizajnuar si duhet për të zbatuar një proces efektiv të mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave.

Komuna e Prizrenit nuk kishte arritur të krijoj parakushte të mjaftueshme, qoftë me kompletimin e bazës ligjore apo ofrimin e hapësirave adekuate për punë, për ti siguruar KRM-së zhvillimin e operimeve në mënyrë adekuate. Ndërsa Kompania ka mangësi në kryerjen e shërbimeve cilësore dhe në përputhje me standardet.

Raportimet lidhur me menaxhimin tek të gjitha institucionet e përfshira është i dobët dhe si pasojë ka mungesën e një llogaridhënie të qartë lidhur me problemet për menaxhimin e mbeturinave.

Rekomandojmë Komunën që të siguroj:

- Formimin e sistemit adekuat për menaxhimin e mbeturinave dhe krijimin e parakushteve për operimin e Kompanisë së pastrimit;
- Krijimin e parakushteve për operimin e Kompanisë së pastrimit, caktimin e vendeve adekuate për vendosjen e kontejnerëve si dhe krijimin e infrastrukturës rregullative;
- Të sigurohet ambient i pastër për qytetaret e KP;
- Të ngritët niveli i organizimit brenda autoriteteve komunale dhe të raportohet sipas kërkesave lidhur me fushën e mbeturinave; dhe
- Formimin e komisionit komunale të aksionarit-KKA, si dhe të ushtrijë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit të KRM-së;

Rekomandojmë Bordin e KRM-së të siguroj që:

- Kompania i kryen shërbimet në përputhje me kërkesat e standardeve për shërbime;
- Shërbimet e pastrimit të shtrihen në tërë territorin e komunës dhe zgjerimin e shërbimeve edhe në zonat rurale; dhe
- Menaxhmenti të siguron organizim të mirë brenda kompanisë për menaxhimin sa më të mirë të mbeturinave dhe ndërmarrjen e masave parandaluese për evitimin e problemeve të paraqitura.

Komunës së Prizrenit dhe Menaxhmentit të KRM Ekoregjioni i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti.

- Më tutje, Komuna e Prizrenit dhe Menaxhmenti i KRM Ekoregjioni kanë pranuar të gjeturat dhe konkludimet tona dhe janë zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Një mjedis i pastër është i një rëndësie të veçantë për vendin dhe ka ndikimet e saj të ndjeshme në shëndetin e popullatës. Theksi i vënë mbi Mjedisin do të reflektojë në pjesën e zhvillimit ekonomik të vendit dhe një varg faktorësh të tjerë.

Gjendja mjedisore në Kosovë aktualisht nuk është e kënaqshme dhe paraqet një ndër sfidat kryesore mjedisore . Në vitin 2011 vetëm 49% e popullatës u janë ofruar shërbime të grumbullimit të mbeturinave komunale. Zonat urbane (qytetet) mbulohen me rreth 90% me shërbime të grumbullimit të mbeturinave ndërsa në zonat rurale mbulohen vetëm rreth 10% e popullatës pranojnë shërbime të tilla.¹ Sipas një vlerësimi të përgjithshëm, dhe bazuar në informatat e paraqitura në planin afatmesëm të KRM Ekoregjionit për vitin 2011 brenda ditës janë mbledhur afërsisht 120 ton mbeturina. Gjatë tërë vitit 2011 janë mbledhur 44,126 ton mbeturina. Ndërsa në vitin 2012 janë mbledhur 46,636 ton mbeturina.

Në regjionin e Prizrenit, shtrirja e rrjetit të shërbimeve në zonat rurale të komunave të regjionit të Prizrenit ende mbetet sfidë. Aktualisht KRM Ekoregjioni me shërbimet e sajë kryesisht mbulon zonat urbane. Në vitin 2011, 35% e popullatës është shërbyer në zonën e shërbimit të Ekoregjionit. Prej tyre 91% e popullatës në zonat urbane dhe vetëm 8.3% e atyre rurale.

Për këtë arsye ZAP në planin e vitit 2012-13 është përcaktuar në kryerjen e disa auditimeve të performances me qëllim të fokusimit në menaxhimin e mbeturinave. Synimi i këtij raporti është shqyrtimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Prizrenit dhe komunat tjera të këtij regjioni – njëri nga katër auditimet që do të kryhet dhe që do të përfshihet në raportin përmbledhës mbi menaxhimin e mbeturinave në Kosovë.

Komunat Prizreni, Suhareka, Dragashi, Rahoveci dhe Malisheva lidhur me çështjet mjedisore janë duke u sfiduar me atë se:

- Një pjese të konsiderueshme të popullsisë nuk ka arritur t’ju ofrojë shërbimin adekuat të grumbullimit të mbeturinave.

Ky auditim është fokusuar në ofrimin e shërbimeve në Prizren dhe Komunat tjera përkatëse të këtij regjioni dhe kornizën ligjore përbrenda të cilës ato ofrohen. Marrëdhënia ndërmjet palëve të përfshira është përmbledhur në kapitullin e dytë.

¹ Raporti i gjendjes së mjedisit 2011-2012

Ne jemi fokusuar vetëm në menaxhimin e mbeturinave komunale për arsye se paraqesin problem direkt dhe serioz për qytetarët e vendit. Po ashtu sistemi i administrimit të mbeturinave në njëfarë mase është kompleks dhe në këtë proces janë të përfshirë disa akterë, gjë që e bënë auditimin potencial më të nevojshëm .

ZAP shpreh falënderimin për të gjitha institucionet dhe stafin e përfshirë për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit dhe për ofrimin e të dhënave të nevojshme.

2 Funksionimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave

Përgjegjësia për administrimin dhe menaxhimin e mbeturinave është e ndarë në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Komunave dhe Kompanive Regjionale të Mbeturinave (KRM). Ministria përfaqëson nivelin qendror ndërsa nivelin lokal e përfaqëson secila komunë për territorin e saj. KRM-të janë kompani publike lokale të licencuara për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave për territorin e komunave përkatëse.

Parimi kryesor i nivelit qendror është mbrojtja dhe përmirësimi i ambientit që ndikon në jetën e qytetarëve të Kosovës. MMPH është përgjegjëse në krijimin e legjislacionit, përcaktimin e politikave të përgjithshme mjedisore dhe licencimin e kompanive për menaxhimin e mbeturinave dhe si prioritet fokusohet në zbatimin e politikave mjedisore. Përgjegjësi e ministrisë është hartimi i strategjisë nacionale për menaxhimin e mbeturinave, e cila përshkruan gjendjen ekzistuese si dhe përcakton objektivat afatgjata të mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave. Në përputhje me strategjinë nacionale ministria përcakton objektivat afatmesme në planin e Republikës së Kosovë (RKS) për menaxhimin e mbeturinave, si dhe mbikëqyrë zbatimin e këtij plani.

Komuna përfaqëson nivelin lokal dhe ka rol kyç në ofrimin e shërbimeve cilësore për të gjithë qytetarët. Është përgjegjësi e komunës të sigurojë që mbeturinat mblidhen dhe deponohen si duhet. Në harmoni me planin e RKS-së për menaxhimin e mbeturinave komuna duhet të sigurojë hartimin dhe zbatimin e planit lokal, në të cilin përcaktohen objektivat afatshkurtra. Legjislacioni i cili ka qenë në fuqi në vitin 2012 për menaxhimin e mbeturinave ishte Ligji 04/L-030 i cili në Maj/2012 është zëvendësuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-060. Me këtë ligjin e ri Komunitat kanë më tepër përgjegjësi dhe obligime për menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre. Këto përgjegjësi përfshijnë përzgjedhjen e kompanive për grumbullim, caktimin e tarifave, rregullimin e sistemit dhe kushteve për mënyrën e mbledhjes së mbeturinave, orarin e mbledhjes, llojin e mbeturinave, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes së kontejnerëve si dhe mënyrën e transportimit të mbeturinave komunale. Këto kompetenca më parë ishin të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) por të cilat janë transferuar tek komuna me ligjin e ri. Për këto kompetenca Komuna ushtron mbikëqyrje dhe kontroll përmes inspektoratit komunal për mjedis. Në këtë mënyrë evidentohen vendet e ndotura dhe duhet të hartohen projekte për sanimin e tyre. Gjatë auditimit tonë ne kemi vlerësuar nëse komuna tashmë vepron sipas përgjegjësive të reja dhe ka zbatuar legjislacionin e ndryshuar.

Në procesin e menaxhimit të mbeturinave rol kyç ka Komuna, pasi që ajo është përgjegjëse për të siguruar ambient të pastër në territorin e saj.

Komuna ka për detyrë të organizoj sistemin për largimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike dhe të stimuloj procesin e ndarjes dhe klasifikimit të mbeturinave gjatë fazave të administrimit. Duhet të rregullojnë sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit, si dhe të përcaktoi orarin për mbledhjen e mbeturinave. Standardet e Shërbimeve të pastrimit përshkruajnë mënyrën e pozicionimit, shpërndarjes dhe densitetit të kontejnerëve.

KRM-të janë ndërmarrje publike lokale për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave të cilat për vitin 2012 ishin të licencuara nga ZRRUM.²Në pajtueshmëri me politikën zhvillimore komunale, KRM-të duhet të hartojnë planin e biznesit që shërben si bazë për arritjen e objektivave të parashikuara për shërbimet që i ofrojnë, si dhe planin operativ me qëllim të përcaktimit të kohës dhe mënyrës së ushtrimit të aktiviteteve për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave i cili duhet të jetë në përputhje me planin komunal. KRM-të për zhvillimin e aktivitetit primar, mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave lidhin kontrata individuale me amvisëritë, bizneset, industrinë dhe institucionet në territorin e tyre. Këto kontrata duhet të lidhen në bazë të kushteve të precizuara në Kartën e konsumatorëve³. Sasia më e madhe e mbeturinave grumbullohet sipas shërbimit “derë me derë”, ndërsa për shërbimet nëpër banesa ky grumbullim bëhet në mënyrë “kolektive”.


Menaxhimi i mbeturinave në hapësirat publike si dhe deponitë e egra të krijuara nuk përfshihen në planet operative të kompanive, ato cilësohen si aktivitete sekondare. Për shërbimet lidhur me këto mbeturina kompanitë lidhin kontrata të veçanta me komunat përkatëse të cilat janë përgjegjëse për largimin dhe përkujdesjen e tyre.

Mbeturinat gjenerohen nga amvisëritë, administrata shtetërore, sektorët e ndërtimit, shërbimet e ndryshme, prodhimi etj. Mbeturinat e gjeneruara grumbullohen pa asnjë ndarje paraprake të tyre, ndërsa problemi rëndohet kur mbeturinat e përditshme akumulohen.

² Ne kemi ekzaminuar nivelin e ofrimit të shërbimeve nga këto kompani, dhe kemi vlerësuar nëse kanë kryer shërbime duke u bazuar në standardet minimale të kualitetit, sigurisë dhe besueshmërisë të cilat i ka përcaktuar ZRRUM. Këto standarde vazhdojnë të jenë të aplikueshme në mungesë të rregullativës së re komunale në përputhje me ligjin në fuqi.

³ Dokumenti i kompanisë i miratuar nga ZRRUM-i me të cilën rregullohen të drejtat dhe përgjegjësitë e ndërsjella ndërmjet KRM-së dhe Konsumatorëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave.

Diagrami 1 Një vijim paraqesim sistemin dhe linjat e raportimit:



Kjo mënyrë e funksionimit të sistemit është e bazuar në tri ligje kryesore:

- Ligji për Mbeturina, i cili rregullon fushën e mbeturinave dhe sipas tij duhet të veproj Ministria, Komuna dhe KRM-ja. Shërbimet e mbeturinave duhet të kryhen sipas kërkesave të këtij ligji;
- Ligji për Ndërmarrjet Publike, në bazë të cilit janë themeluar të gjitha KRM-të dhe
- Ligji për Shoqëritë Tregtare, sipas të cilit KRM-të janë të organizuara si Shoqëri Aksionare.

Ashtu siç është e prezantur në diagramin 1 KRM-të sipas Ligjit të Mbeturinave duhet të përgatisin raport për menaxhimin e mbeturinave dhe të dorëzojnë atë në Komunë dhe në Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit si pjesë e Ministrisë së Mjedisit.

Komuna duhet të hartoj raport vjetor për realizimin e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave dhe të dorëzojë në Ministri deri më 31 Mars të vitit vijues. Ndërsa Ministria

harton çdo vit raport mbi menaxhimin e mbeturinave në Republikën e Kosovës dhe e dorëzon në Qeveri në tremujorin e dytë të vitit vijues.

Sipas Ligjit të NP-ve, menaxhmenti i KRM-ve i raporton Bordit të Drejtorëve (BD). Bordi i raporton Komisionit Komunal të Aksionarëve (KKA) në baza tre mujore dhe përmes raporteve vjetore, ndërsa KKA një herë në vit raporton para Kuvendit Komunal (KK) për mënyrën e menaxhimit të KRM-ve. Këto janë të analizuara në shtojcën 1 të këtij raporti.

2.1 Funksionimi i KRM-së

Kompania Regjionale e Mbeturineve Ekoregjioni është ndërmarrje publike lokale, në pronësi të Komunës së Prizrenit, Suharekës, Rahovecit, Dragashit dhe Malishevës, e rregulluar me aksione, kryeson Prizreni me 63% të aksioneve. Lokacioni i kompanisë është në Prizren ndërsa i njëjtit në komunat përkatëse. Kompania ofron shërbime në grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, me qëllim të zgjerimit në zonat rurale dhe zhvillimit të aktiviteteve sekondare. Ekoregjioni prej Janar/2008 operon si Kompani Regjionale e Mbeturineve "Ekoregjioni" Sh.A.

Zona e shërbimit të KRM Ekoregjioni përfshijë pesë (5) Qytete: Prizreni, Dragashi, Suhareka, Malisheva, Rahoveci dhe në të ardhmen edhe Mamusha. Përfshin 229 fshatra, ndërsa rreth 468,482 banorë jetojnë në zonën e shërbimit të KRM Ekoregjioni. Rreth 157,000 banorë jetojnë në qytete, përderisa 329,842 jetojnë në zonat rurale. Në vitin 2012 Ekoregjioni kishte 180 punëtorë⁴.

Aktivitetet e kompanisë i menaxhon Kryeshefi Ekzekutiv, i cili siguron funksionimin e kontrolleve dhe raporton rregullisht para Bordit të Drejtorëve.

Cilësia e shërbimeve që duhet ti ofroj KRM janë përcaktuar me Standardet e Shërbimit për Ofertuesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturineve. Standardet përcaktojnë rregulla/standarde mbi kualitetin, besueshmërinë dhe sigurinë e shërbimeve që duhet të përmbushë KRM ndaj konsumatorëve.

Komuna ka për detyrë të krijoj parakushte KRM-së për kryerjen e shërbimeve të pastrimit sipas këtyre standardeve. Po ashtu të evidentojë vendet e ndotura, të hartojë projekte për sanimin e tyre dhe të pastrojë hapësirat publike.

⁴ Të dhënat nga plani afatmesëm 2012-2014 dhe nga intervistat me zyrtarët kompetent

Mënyra e ofrimit të shërbimit të organizuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave nga KRM Ekoregjioni është e organizuar në formën e bazuar të zonave të banimit brenda komunës. Shpeshtësia e grumbullimit, numri dhe lloji i kontenjerëve është i definuar për tri lloje të vendëbanimit:

- vendbanimet kolektiv dhe qendra e qytetit;
- vendbanimet individual mbrenda qytetit; dhe
- sektori i fshatrave në kuadër të komunës.

Në kapitullin 2 ne kemi përshkruar sistemin në përgjithësi. Shtojca III jep një pasqyrë të standardeve dhe kriterëve për dhënien e shërbimeve dhe vlerësimin e ofrimit të shërbimeve nga KRM Ekoregjioni. Kapitulli në vijim nxjerr në pah gjetjet më të rëndësishme në lidhje me ofrimin e shërbimeve.

3 Të gjeturat e KRM-së

Mbulimi i ultë i territorit komunal me shërbime pastrimi, është faktor ndikues për një ambient të pa pastër. Aktualisht KRM Ekoregjioni me shërbimet e sajë kryesisht mbulon zonat urbane. Në vitin 2011, 35% e popullatës është shërbyer në zonën e shërbimit të Ekoregjionit. Prej tyre 91% e popullatës në zonat urbane dhe vetëm 8.3% e atyre rurale.

Shtirja e rrjetit të shërbimeve në zonat rurale të komunave të regjionit të Prizrenit ende mbetet sfidë, kjo sjellë efekte negative për mbrojtjen e ambientit dhe administrimin e mbeturinave, pasi nuk ka fare kontroll dhe mbikëqyrje se ku përfundojnë mbeturinat e këtyre qytetarëve të cilët nuk mbulohen nga shërbimet e KRM-së. As autoritetet komunale nuk kanë marrë ndonjë veprim për të siguruar shërbime të pastrimit në tërë territorin komunal.

KRM Ekoregjioni disa here kishte bërë përpjekje për zgjerimin e rrjetit të shërbimeve në zonat rurale, por kanë dështuar për arsye të mos gatishmërisë së qytetarëve për të lidhur kontrata dhe për të paguar shërbimet.

Regjistrimi i konsumatorëve dhe mungesa e lidhjes së kontratave me qytetarët. KRM Ekoregjioni ende nuk ka arritur të lidhë kontrata me të gjithë konsumatorët por edhe regjistrimi i tyre nuk është i plotë. Deri në vitin 2011 janë regjistruar 25,999 konsumatorë, prej tyre 23,855 klient të amvisërisë, 4,022 klient të bizneseve dhe industrisë dhe 486 klient të institucioneve. Kontratat e nënshkruar janë nga klientët e bizneseve, industrisë dhe të institucioneve, përderisa klientët e amvisërisë nuk kanë kontrata.

Lidhja e kontratave individuale kërkohet me Standardet e Shërbimeve. Këto kontrata duhet të lidhen dhe përpilohen sipas kushteve në kartën e konsumatorëve. Në Kartë përshkruhen rregulla dhe obligimet e ndërsjella ndërmjet KRM dhe konsumatorëve. Aty përshkruhet mënyra e faturimit, tarifat, orari i mbledhjes së mbeturinave dhe nënshkrimi i këtyre kontratave është i obliguar për konsumatorët.

Niveli i ultë i inkasimit, është një tjetër faktor që ndikon në procesin e shërbimeve të pastrimit. Inkasimi i mjeteve nuk është i mirë në zonat ku kryhen shërbimet. Një numër i lartë i konsumatorëve, nuk i paguajnë me rregull faturat e tyre lidhur me shërbimet që i ofron kompania. Niveli i inkasimit në raport me faturimin është rreth 67%. Lidhur me inkasimin e mjeteve kompania nuk është treguar mjaft efikase dhe mungonte një organizim dhe kontroll adekuat mbi inkasantët.

Kjo qasje mund të ketë efekte negative, në njërin anë nuk zbatohen rregullat lidhur me nivelin dhe cilësinë e shërbimeve që duhet të kryej kompania e në anën tjetër mund të ndikoj në krijimin e deponive të egra dhe në hedhjen e mbeturinave në hapësira publike.

Kompania duhet të regjistroj të gjithë konsumatorët dhe të siguroj futjen e plotë të tyre në sistemin e shërbimeve të saj. Të promovoj shërbime cilësore dhe të gjej mënyra shtesë që qytetarët të jenë të gatshëm për lidhjen e kontratave. Mungesa e kushteve kontraktuale mund të ketë pasojë nivelin e ultë të inkasimit, dhe rrjedhimisht krijimin e deponive të egra.

Të gjeturat në vijim kanë të bëjnë me menaxhimin e KRM-së që ndërlidhen me problemet e lartcekura në ofrimin e shërbimeve, sigurimi i menaxhimit në kontrollin e duhur mund të ndihmoj në luftimin e sfidave të lartcekura.

Hulumtimi rreth kënaqësisë së konsumatorëve, Ligji i NP-ve kërkon që kompania të përgatitë raporte të rregullta vjetore mbi kënaqshmerinë e konsumatorëve me ofrimin e shërbimeve. Hulumtimi dhe përgatitja e këtij raporti ka për qëllim nxjerrjen e rezultateve se sa kompania po arrin të përmbush nevojat e konsumatorëve. Kjo e ndihmon kompaninë në identifikimin e problemeve. Në bazë të rezultateve të tij mund të merren veprimet përmirësuese.

Gjatë vitit 2012 është kryer një hulumtim⁵ për kënaqësinë e konsumatorëve, dhe si rezultat i kësaj jo të gjithë konsumatorët janë të kënaqur me shërbimet e ofruara.

Agjensioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), ka për qëllim zgjerimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për të gjithë qytetarët. Për të zgjeruar shërbimet në zonat të cilat aktualisht nuk kanë shërbim grumbullimi, ka parë të nevojshme të bëhet një hulumtim për të verifikuar gatishmërinë e pjesëmarrjes publike të këtyre zonave në zgjerimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave.

Ky studim reflekton opinionin publik të qytetarëve të Prizrenit, në lidhje me gjendjen aktuale të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, pritjet e tyre dhe njohuritë mbi përfitimet e ripërdorimit dhe riciklimit. Raporti prezanton opinionin publik të të gjitha grup moshave, gjinive dhe etnive bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë në Komunën e Prizrenit; 400 amvisëri dhe 100 entitete biznesi me intervista sy më sy, të cilat janë kryer në pjesën e dytë të Tetorit. Secila intervistë ka zgjatur rreth 25 minuta.

Në përgjithësi, 49,6 % e amvisërive të intervistuar dhe 60,5 % të bizneseve të intervistuar janë të kënaqur deri në një masë me shërbimin aktual të grumbullimit. Nevojiten përmirësime në shërbimin aktual të grumbullimit. Mes tjerave, 36,8 % e amvisërive dhe 25 % e bizneseve janë të pakënaqur me frekuencën e grumbullimit.

⁵ Hulumtimi është kryer nga JICA

Plani i biznesit për vitin 2012, ndihmojnë kompaninë në përcaktimin e objektivave dhe krijimin e strategjive. Plani Afarist duhet të analizojë së paku, si vijon:

- Një përshkrim të synimeve afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen nga NP si dhe orarin për realizimin e tyre;
- Mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre synimeve;
- Përcaktimin e shpenzimeve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrës;
- Për financimin e shpenzimeve;
- Veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve; dhe
- Detyrimet e NP karshi konsumatorëve dhe publikut.

KRM "Ekoregjioni" SH.A nuk ka përgatitur plan biznesi për vitin 2012, mirëpo ka përgatitur Planin afatmesëm të Biznesit për vitin 2012-2014. I njëjti është aprovuar nga Bordi i Drejtoreve në Gusht të vitit 2012.

Plani është dokument bazikë për zhvillimin e aktiviteteve të kompanisë. Andaj përgatitja e tij është esenciale dhe duhet të përcjelljet në secilën periudhë.

Funksionimi jo i mirë i kontrolleve të brendshme, nuk sigurojnë arritjen e objektivave dhe menaxhimin e duhur në kompani. Kompania ende nuk ka krijuar mjedis adekuat të kontrollit të brendshëm. Rregulloret aktuale nuk janë të mjaftueshme dhe funksionimi i fushave kyçe në kompani nuk ishin rregulluar, siç janë: fusha e të hyrave, shpenzimeve, personelit, operatives dhe kontabilitetit.

Aktivitetet e kontrollit nuk janë të mjaftueshme, mungesa e efikasitetit të tyre është vërejtur sidomos në proceset operative, shërbimit financiar dhe të konsumatorëve.

Aktivitetet e kontrollit - Ekoregjioni në përgjithësi nuk ka një sistem efikas të kontrollit. Mungojnë kontrolle parandaluese funksionale, të cilat do të ndalojnë ndodhjen e ngjarjeve të pa dëshirueshme. Si rezultat i kësaj nuk kishte planifikim të mirëfilltë për vitin 2012, pastaj nuk kishte objektiva qartë të përcaktuara dhe synime për të matur performancën.

Informacioni dhe komunikimi – Sistemet e informacionit prodhojnë raporte në kohë që përmbajnë informacion financiar. Bazuar në intervista me nivele të ndryshme të stafit kemi vërejtur që ekziston komunikimi në të gjitha drejtimet.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në këtë rast nuk funksionon si duhet andaj gjendja aktuale e kompanisë dhe performanca e saj nuk është e kënaqshme.

Konkluzion

Pengesat e shfaqura në procesin e grumbullimit dhe mbledhjes së mbeturinave ndikojnë në cilësinë dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve. Nuk janë krijuar parakushte për operim të duhur të kompanisë. Mosgatishmëria e konsumatorëve për të lidhur kontrata me KRM dhe për të paguar për shërbimet ishte shkaku kryesor i dështimit të zgjerimit të shërbimeve në zonat rurale.

Përkundër dobësive të cekura në këtë raport, duhet theksuar se kompania ka bërë përpjekje që të kryej aktivitetet e saj në mënyrë sa më të mirë me gjithë vështirësitë që ka.

4 Menaxhimi i mbeturinave nga niveli komunal

Komuna nuk ka krijuar një organizim të mirë lidhur me menaxhimin e mbeturinave në territorin e sajë. Për më tepër janë shfaqur këto dobësi:

Ndarja dhe klasifikimi i mbeturinave, është standard që kërkohet në procesin e pastrimit të ambientit. Në Komunën e Prizrenit dhe komunat tjera përkatëse të këtij regjioni ende nuk ka filluar procesi i ndarjes dhe klasifikimit të mbeturinave komunale. Nuk ka ndonjë plan për orarin dhe mënyrën e mbledhjes së mbeturinave.

Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave, duhet të hartohet në përputhje me planin nacional. Në të duhet të përfshihen të gjitha kriteret e përcaktuara me ligj me qëllim të menaxhimit dhe administrimit adekuat të mbeturinave në territorin komunal. Ndërsa një herë në vit duhet të përgatitet raport vjetor për menaxhimin e mbeturinave dhe realizimin e planit lokal. Ky raport duhet të dorëzohet në Ministri.

Komuna e Prizrenit nuk ka hartuar planin lokal, kjo është arsyetuar me mungesën të planit nacional. Pasi që MMPH nuk e ka hartuar planin strategjik nacional mbi menaxhimin e mbeturinave, as komuna nuk ka përgatitur raportin vjetor për menaxhimin e mbeturinave.

Me mungesën e planit lokal dhe të raportimit përveç se nuk janë respektuar kërkesat ligjore, kanë shkaktuar edhe efekte jo të mira për sistemin e administrimit të mbeturinave. Se pari mungesa e planit ndikon në organizimin komunal për menaxhimin e mbeturinave si dhe kompania e cila ka ofruar shërbime pastrimi ka operuar pa ndonjë plan paraprak në territorin e saj të veprimit. Mos raportimi ka efekt negativ pasi që ka mbajtur Ministrinë të pa informuar për gjendjen e mbeturinave në Komunën e Prizrenit.

Mbikëqyrja nga inspektorati komunal, Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave përmes inspektorit komunal për mjedis. Inspektori komunal ka për obligim që të sigurojë mbikëqyrjen e zbatimit të planeve, ligjit për mbeturina dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij.

Autoritetet komunale duhet të sigurojnë mënyra për të siguruar funksionimin e sistemit dhe zbatimin e rregullave mjedisore.

Inspektorati komunal nuk ka arritur të siguroj zbatimin e duhur të ligjit për mbeturina dhe rregulloreve komunale për këtë çështje. Plan për menaxhim të mbeturinave nuk kishte. Përkundër gjendjes jo të mirë në teren, gjatë vitit 2012 inspektorati nuk ka lëshuar asnjë gjobë mandatore, të cilën inspektori mund ta lëshoj gjatë vizitës inspektive në terren.

Konkluzion

Komuna e Prizrenit dhe komunat tjera përkatëse të këtij regjioni ende nuk kanë siguruar sistem të qartë për mbikëqyrjen dhe administrimin e mbeturinave. Nuk janë krijuar parakushte që kompania të zhvilloj aktivitetet pa pengesa.

5 Mbikëqyrja e kompanisë së mbeturinave

Në bazë të ligjit për ndërmarrje publike kompania drejtohet dhe mbikëqyret nga Bordi i Drejtoreve dhe komisioni i auditimit i cili zgjidhet nga bordi. Ndërsa në emër të aksionarit kompania mbikëqyret nga Komisioni Komunal i Aksionareve. Qëllimi kryesor i organeve mbikëqyrëse është sigurimi i shërbimeve të mira dhe performanca e kompanisë.

Komisioni komunal i Aksionarit - KKA - Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, KKA-ja zgjidhet në bazë të Ligjit të NP-ve si organ përfaqësues i Aksionarit. Ka rol mbikëqyrës se si drejtohet dhe menaxhohet kompania dhe për këtë e informon Kuvendin Komunal. Andaj në mungesë të këtij komisioni, komunat nuk kanë arritur të realizojnë:

- Miratimin dhe nxjerrjen e Politikës së pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të komunës në lidhje me pronësinë e NP-së Lokale si dhe rolin e saj në qeverisjen korporative të NP-së Lokale;
- Mbikëqyrjen nga Aksionarët, ku Aksionari do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtoreve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së; dhe
- Raportimin para publikut mbi performancën e aksionarëve, Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësive, si dhe mbi arritjen e objektiveve të përcaktuara në politikën e pronësisë, si dhe do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të NP-së përkatëse Lokale në interes të Komunës.

Nuk ishte mbajtur as takimi vjetor i aksionarëve. Mbajtja e këtij takimi kërkohet me ligj dhe në të merren vendimet më të rëndësishme strategjike për një Shoqëri Aksionare.

Mos formimi i këtij komisioni, ka ndikuar në zbehjen e procesit të mbikëqyrjes dhe informimit të Aksionarit për menaxhimin e mbeturinave.

Bordi i drejtorëve, Roli i Bordit është drejtimi i kompanisë drejt rezultateve dhe mbikëqyrës direkt i punës së Menaxhmentit duke përfshirë edhe llogaridhënien para komisionit(eve) komunale të aksionarit.

Mirëpo këto obligime nuk janë arritur si duhet, nuk është bërë plan biznesi vjetor i kompanisë për vitin 2012, por është bërë një plan afatmesëm 2012-2014, i cili është aprovuar nga bordi në Gusht të vitit 2012, bordi nuk kishte kërkuar arsye për mos përgatitje të plan biznesit vjetor.

Raportimi i Bordit në Komunitat përkatëse nuk është i qartë përderisa mungojnë Komisionet komunale të aksionarit, nuk janë dorëzuar raporte tremujore dhe vjetore në komuna në përputhje me ligjin e NP-ve.

Mos kryerja (arritja) e obligimeve nga ana e bordit ka rezultuar me nivel të ulët të drejtimit të kompanisë drejt rezultateve, mbikëqyrjes së punës së menaxhmentit dhe procesit të llogaridhënies.

Konkluzion

Organet mbikëqyrëse nuk kanë funksionuar si duhet, nuk kanë arritur të mbikëqyrin këtë proces dhe nuk kanë siguruar informimin e Kuvendit Komunal.

Mungesa e formimit të Komisionit(eve) Komunal të Aksionarit, ka ndikuar që mbikëqyrja të mos arrij efektin e duhur.

Mos informimi i Kuvendit Komunal e ka mbajtur çështjen e mbeturinave komunale edhe më tej të pa adresuar.

Mungesa e drejtimit të kompanisë drejt rezultateve pozitive nga BD dhe raportimi jo i mirë kanë dhënë efekte negative.

Rekomandimi 1

Rekomandimet ndërlidhet me shërbimet e ofruara dhe i adresohet kryeshefit të KRM-së që të sigurojë;

- Shtrirjen e shërbimeve në tërë territorin e Regjionit të Prizrenit dhe zgjerimin e shërbimeve edhe në zonat rurale;
- Shërbimet e ofruara të janë në nivelin e pritur, të bëhet planifikimi i mirë i aktiviteteve në mënyrë që performanca të jetë e matshme dhe të arrihen objektivat e kompanisë, si dhe shërbimet të monitorohen dhe raportimet të jenë të strukturuar dhe cilësore duke përbajtur informata thelbësore për veprimtarinë e KRM; dhe
- Funksonimin e kontrolleve brenda kompanisë në mënyrë që të arrihen rezultatet e pritura.

Rekomandimi 2

Rekomandimet ndërlidhet me nivelin komunal dhe i adresohet Kryetarit të Komunës që:

- Analizimin dhe gjetjen e mundësive për lidhjen e kontratave me të gjithë konsumatorët të cilëve ju ofrohen shërbimet;
- Të filloj zbatimin e procesit të ndarjes dhe klasifikimit të mbeturinave komunale sipas standardeve të kërkuara në mënyrë që të krijohet një ambient më i pastër për qytetarët;
- Të siguroj sistem dhe kushte për menaxhimin e mbeturinave. Sistemi duhet të planifikohet, të organizohet dhe të monitorohet si duhet nga autoritetet komunale;
- Drejtoritë komunale të organizohen si duhet dhe të shkëmbejnë informata ndërmjet tyre për të përmirësuar sistemin në sektorin e ambientit;
- Të zhvillojë parimet e llogaridhënies në përputhje me përgjegjësit që kanë ndaj ministrisë dhe kompanive të mbeturinave; dhe
- Plotësojnë infrastrukturën rregullative në nivelin komunal në përputhje me aktet ligjore.

Rekomandimi 3

Rekomandimet ndërlidhet me procesin e mbikëqyrjes dhe i adresohet Kuvendit Komunal të sigurojnë që:

- Komuna e Prizrenit dhe komunat tjera përkatëse të sigurojnë: sistem dhe kushte për menaxhimin e mbeturinave, planifikim, organizim dhe monitorim të duhur lidhur me administrimin e mbeturinave komunale;
- Komuna të formoj Komisionin(et) Komunal të Aksionarit, përmes të cilit do të ushtroj të drejtat e aksionarit, të nxjerr politikën e pronësisë dhe të miratoj atë, të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së, si dhe të siguroj raportimin para publikut mbi performancën e aksionarëve;
- KK të siguroj raporte cilësore nga KKA-ja që të sigurohet se kompania e licencuar për mbeturina menaxhohet mirë dhe kryen shërbimet e pritura;
- KKA-ja të jetë produktive në mbikëqyrjen e punës së BD dhe mënyrës se si menaxhohet kompania;
- BD të jetë më aktiv në drejtimin e kompanisë, duke u fokusuar në rezultate dhe nxjerrjen e rregulloreve të duhura për kompaninë.

Shtojca I: Metodologjia e auditimit

Ne kemi kryer auditim në Kompaninë e Mbeturinave Ekoregjioni duke përfshirë edhe përgjegjësit Komunal për menaxhimin e mbeturinave.

Në këtë auditim kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi intervistuar zyrtarë përgjegjës në Komuna dhe në KRM, dhe kemi rishikuar punën për menaxhimin e mbeturinave;
- Kemi rishikuar sistemin mbikëqyrës, rregulloret, politikat dhe aktivitetet e ndërmarra nga Komuna;
- Kemi ekzaminuar nëse është formuar Komisioni Komunal i Aksionarëve në rolin mbikëqyrës të Kompanisë;
- Kemi rishikuar sistemin e kontrolleve të vendosura nga KRM , takimet e BD, Komisionit të Auditimit, si dhe vendimet e marra për implementimin e tyre nga menaxhmenti lidhur me menaxhimin e aktiviteteve operacionale;
- Kemi analizuar planet dhe raportet operative lidhur me grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave për të parë se deri ku kanë arritur planet; dhe
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të testeve, intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë shërbimeve.

Shtojca II: Kërkesat ligjore/administrative të cilat ndikojnë në menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Prizrenit dhe Komunat tjera përkatëse të këtij regjioni

Organizata	Raportimet	veprimet që duhet të ndërmerren nga Komuna dhe KRM	Përmbushja e kritereve nga akteret relevant		
Komuna	1. Raportin vjetor lidhur me mbeturinat e dergon ne Ministri	1. Përgatit planin lokal te veprimit.	Jo		
		2. Cakton tarifafat	Jo	Me ligjin e ri caktimi I tarifave fillon prej viti 2013	
		3. Evidentimi i vendeve te ndotura për territoret e tyre.	Pjesërisht	Nuk kanë të pëgaditur dokumentacion ose raport lidhur me vendet e ndotura brenda territorit komunal	
		4. Mbikëqyrjen dhe kontrollin përmes inspektorit komunal te mjedisit.	Pjesërisht	Inspektorati ka kryer inspektime të ndryshme, mirëpo nuk ka zbatuar rregulloren komunale e cila kërkon lëshimin e gjobave mandatore	
		5. Me akte nënligjore përcaktojnë kushtet dhe rregulloret për menaxhimin e mbeturinave.	Pjesërisht	Kanë rregullore, mirëpo nuk e kanë të qartësuar rolin e autoriteve komunale lidhur me menaxhimin e mbeturinave	
		6. Komuna me Akt te veçantë rregullon sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes dhe riciklimit te mbeturinave, orarin për mbledhjen e mbeturinave dhe mënyrën e shpërndarjes se kontinjereve, mirëmbajtjen e vendeve ku	Jo	Eksistojnë një vendim komunal për rregullimin e qytetit dhe të shërbimeve komunale, i nxjerrur në vitin 2004. Ky vendim përcakton kushtet dhe mënyrën e mirëmbajtjes së pastërtisë së hapësirave publike, bartja dhe deponimi i mbeturinave nga Qyteti dhe vendbanimet rurale. Ndërsa sa i përket caktimit të tarifave dhe mënyrën e transportimit të mbeturinave duhet të rregulloret prej	

		grumbullohen mbeturinat dhe mënyrën e transportimit të mbeturinave.		vitit 2013
		7. Harton infrastrukturen dhe aktet nënligjore	Jo	
		8. KKA duhet të themelohet	Jo	KKA, Nuk është themeluar fare
		9. Përvoja e Komisionit duhet të jetë me kompetenca të përcaktuara në ligj	Jo	Nuk ka komision të formuar
		10. Nxjerrja e politikës së pronës dhe miratimi i saj	Jo	
KKA	1. Raporton lidhur se si është duke u menaxhuar kompania dhe se si janë duke I ushtruar obligimet e tyre dmth KKA ndaj kompanise	1. Një herë në vit duhet të raportoj te Kuvendi Komunal	Jo	Në mungesë të këtij komisioni, nuk ka patur raportime
		2. Mbikëqyr punën e Bordit dhe të kompanisë	Jo	
		3. Emëron anëtarët e Bordit dhe i shkarkon nëse performanca e bordit nuk është e mirë	Jo	

BD	1. Bordi i miraton ato raporte edhe i përcjell te KKA nese eksiston nje e tille ne baza tre mujore			Nuk kanë raportuar në KKA, pasi që nuk ka pasur një komision të tillë të formuar nga Komuna
		1. Miraton planin rregulloret, statutin e kompanisë	PO	
		2. Miraton planin vjetor të biznesit dhe strategjik të kompanisë	Pjesërisht	Nuk ka plan vjetor por vetëm një plan afat mesëm
		3. E siguron sistemin e kontrollit	Pjesërisht	Nuk janë siguruar rregulloret e mjaftueshme për funksionimin e brendshëm
		4. Emëron zyrtarët kryesorë të kompanisë	Po	
		5. Komisioni i auditimit e vlerëson performancën e zyrtarëve kryesor të kompanisë dhe e ka të drejtën t'i shkarkoj nëse nuk ka performancë të mirë	Jo	

Shtojca III: Pasqyra e standardeve dhe kriterëve për dhënien e shërbimeve dhe vlerësimin e ofrimit të shërbimeve nga KRM Ekoregjioni

Organizata	Kriteret sipas ligjit si duhet të jenë	Veprimet që duhet të ndërmerren nga KRM Ekoregjioni	Përmbushja e kriterëve nga KRM Ekoregjioni		Komentet
KRM	1. Përgatitja e raporteve të rregullta operative dhe financiare për BD		PO		
	2. Përgatitja e raportit vjetor lidhur me mbeturinat për MMPH dhe në komunë		Jo		
	3. Menxhmenti informohet përmes planeve nacionale dhe lokale për mbeturina		Jo		
	4. Në aspektin e menaxhimit KE informohet nga raportet e departamenteve të brendshme		Po		
		1. Aktiviteti primar është mbledhja dhe bartja e mbeturinave në tërë territorin e regjionit të Prizrenit; duke përfshi komunën e Prizrenit,			Pjesërisht

		Rahovecit, Suharekës, Malishevës, Dragashit dhe Mamushës.			
		2. Ofrimi I shërbimeve sipas standardeve të ZRRUM-it		Pjesërisht	Mungojnë raportet që dëshmojnë se shërbimet kryhen në përputhje e standardet
		2.1 Orari i shërbimeve nuk duhet te jete ndermjet ores 23-06		Pjesërisht	Nuk ka dëshmi te mjaftueshme
		2.2 Kontinjeret komunal duhet te pastrohen 2 here ne jave		Pjesërisht	Nuk ka dëshmi te mjaftueshme
		2.3 Shërbimet e mbledhejes se mbeurinave te amviserise shtepi per shtepi 1 here ne jave dita e njejte		Po	Nuk ka dëshmi te mjaftueshme
		2.4 Shpeshtesia duhet te rritet ne menyre te parandalimit te grumbullimit te mbeturinave ne toke		Jo	Nuk janë kryer analizat për këtë kriter
		2.5 Pozicionimi, shpërndarja dhe densiteti i kontinjereve ne vende te posaqme, ne mënyre qe te mos pengohet qarkullimi i qytetareve dhe automjeteve		Jo	
		2.6 Ne zonat urbane kontinjeret e amviserise jo me larg se 200 metra		Pjesërisht	Mungon harta e qartë e vendosjes së

		njeri prej tjetrit			kontejnerëve
		2.7 Kapaciteti volumetrik i kontinjerit komunal nuk duhet te jete me i vogel se 1m kub per 150 banore ne dite		Jo	
		2.8 Pastertia e lokacionit te kontinjereve dhe ripozicionimi i tyre		Po	
		2.9 Forma e transportit ne hapsira dhe rruget publike duhet te jete I mbyllur dhe I sigurt		Po	
		3. Ofrimi I sigurisë nga kompania për përmbushjen e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave (mjeteve financiare dhe paisjeve)		Pjesërisht	Për ndryshim nga e kaluara, tani në vitin 2013, fal një donacioni Japan - Kompanija ka kapacitete (pajisje) të mjaftueshme